

VENDIM
Nr. 18, datë 12.5.2015

PËR LICENCIMIN SHA “UJËSJELLËS KANALIZIME KUKËS”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit operatorit sh.a. “Ujësjellës Kanalizime Kukës”, me:

Drejtues ligjor: Zylfi Elezaj.

Drejtues teknik: Mirgen Syla.

2. Operatori sh.a. “Ujësjellës Kanalizime Kukës” autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Kukës, komuna Bicaj, Shtiçen.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare deri më datë 11.5.2017.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Avni Dervishi